

Kushtetuesja në
Shqipëri rikthen
Veliain në krye
të Tiranës



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KONJUFCA MANDATAR PËR QEVERINË E RE, PARTITË E TJERA INSISTOJNË NË ZGJEDHJE TË REJA



Këshilli i Përgjithshëm i Lëvizjes Vetëvendosje ka emëruar Glauk Konjufcën si mandatar për kryeministër. Kjo ndodhi një ditë para skadimit të afatit 10-ditor të presidentes Vjosa Osmani për të dhënë mandatin për formimin e qeverisë së re. Ndërkaq Albin Kurti do të jetë kandidat për zëvendëskryeministër dhe ministër të Punëve të Jashtme. Në rast se presidentja Osmani e mandaton Konjufcën, në bazë të Kushtetutës së Kosovës, ai do të ketë afat 15 ditë që të paraqesë para organit ligjvënës përbërjen e re të ekzekutivit, i cili duhet të marrë të paktën 61 vota në favor

KRYEQYTETI
NË ZGJEDHJE:
PRISHTINASIT
PRESIN FUNDIN E
'KAOSIT URBAN'

F. 3



KU NGEÇI
KOSOVA
SIPAS
RAPORTIT TË
PROGRESIT

F. 6



AKTUALE



VDES ISH-NËNPRESIDENTI
AMERIKAN, DICK CHENEY F. 2

KFOR-i THOTË SE SITUATA
E SIGURISË NË KUFİ ËSHTË E
QETË, PAS RAPORTIMEVE PËR
RRËMBIMIN E NJË SERBI F. 5

PUNËTORËT E RTK-së
PROTESTOJNË TË ENJTEN PËR
MUNGESËN E PAGAVE F. 7

EKONOMI



MINATORËT KËRKOJNË RRIJTJE
PAGASH DHE VLERËSIM PËR
PUNËN E TYRE F. 8

RIZVANOLLI THOTË SE B1 GARANTON
ENERGJI TË QËNDRUESHME EDHE
PËR 20 VJET F. 8

SPORT



KOMBËTARJA E VAJZAVE TË
KOSOVËS MËSON KUNDËRSHTARET
PËR KUALIFIKUESET
E BOTËRORIT 2027 F. 11

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Buniamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

VDES ISH-NËNPRESIDENTI AMERIKAN, DICK CHENEY



UASHINGTON, 4 NËNTOR - Dick Cheney, forca shtytëse mbrapa pushtimit amerikan në Irak më 2003, ka vdekur në moshën 84-vjeçare. Ai është përshkruar nga historianët si njëri prej nënpresidentëve më të fuqishëm në historinë amerikane. Familja e tij ka bërë të ditur të martën se ai ka vdekur më 3 nëntor nga komplikimet e pneumonisë dhe sëmundjet kardiale dhe vaskulare. Cheney i Partisë Republikane - dikur edhe kongresist i Uajominut dhe Sekretar i Mbrojtjes - ka qenë figurë shumë

e rëndësishme në Uashington kur George W. Bush, e ka zgjedhur të jetë kandidati me të cilin do të garonte për garën presidenciale të vitit 2000, të cilat e pati fituar. Si nënpresident prej vitit 2001 deri më 2009, Cheney ka luftuar për zgjerim të kompetencave të presidentit, duke thënë se ato ishin tkurrur dukshëm prej skandalit Watergate, i cili pati rezultuar me largimin e ish-shefit të tij, Richard Nixon prej pushtetit. Cheney i ka zgjeruar edhe kompetencat e zyrës së nënpresidentit, duke e bërë bashkë ekipin për siguri

kombëtare, që shpesh ka shërbyer si qendra kryesore brenda një administrate. Ai ka qenë mbështetës i madh i pushtimit të Irakut më 2003 dhe ka qenë në mesin e zyrtarëve të administratës së Bushit që ka paralajmëruar për rrezikun nga rezervat e dyshuara të armëve të shkatërrimit në masë të Irakut. Si përfundim, armë të tilla nuk u gjetën asnjëherë. Cheney ka pasur probleme me zemrën në pjesën më të madhe të jetës, meqë me sulmet e para ishte përballur në moshën 37-vjeçare. Ai i ishte nënshtruar transplantit të zemrës më 2012.

PEZULLOHET HETIMI KUNDËR DODIKUT DHE TË TJERËVE PËR “SULM NDAJ RENDIT KUSHTETUES” TË BOSNJËS

SARAJEVË, 4 NËNTOR - Prokuroria e Bosnje dhe Hercegovinës pezulloi hetimin kundër ish-presidentit të Republikës Sërpska, Millorad Dodik, ish-kryeministrit të Republikës Sërpska, Radovan Vishković, dhe kryetarit të Kuvendit të Republikës Sërpska, Nenad Stevandić, të cilët dyshoheshin për veprën penale të sulmit ndaj rendit kushtetues të Bosnje dhe Hercegovinës, iu konfirmua “Radios Evropa e Lirë” më 4 nëntor. Arsyeja për pezullimin e hetimit, siç iu tha “REL”-it, është se “nuk ka prova të mjaftueshme që të dyshuarit kanë kryer veprën penale”. Vendimi për pezullimin e hetimit do të thotë se nuk do të ngrihet asnjë aktakuzë. Ai vjen disa ditë pasi Dodik dhe partnerët e tij politikë e biznesorë u hoqën nga lista e zezë e Departamentit të Thesarit të ShBA-së. Lënda u krijua në fillim të vitit, pasi Kuvendi i Republikës Sërpska miratoi disa ligje që ndalonin funksionimin e institucioneve shtetërore gjyqësore dhe policore



në territorin e këtij entiteti, e të cilat Gjykata Kushtetuese e Bosnje dhe Hercegovinës i shpalli jokushtetuese. Zyra e Prokurorit tha atëkohë se ka arsye për të dyshuar se tre zyrtarët më të lartë të entitetit serb të

Bosnjës kanë organizuar një përpjekje për të përmbysur rendin kushtetues të shtetit. Hetimi ishte në qendër të vëmendjes së publikut për muaj të tërë. Ngjarja kulmoi në mars të këtij viti,

kur Gjykata e Bosnje dhe Hercegovinës, për shkak të mosreagimit të tyre ndaj thirrjeve për t'u marrë në pyetje, urdhëroi ndalimin e tyre dhe lëshoi një urdhër arresti. Ai ishte i vlefshëm që nga 17 marsi

dhe të gjitha agjencitë policore në Bosnje dhe Hercegovinë kishin urdhër për ndalimin e tyre. Dodik shkoi vullnetarisht në Prokurorinë e Bosnje dhe Hercegovinës më 4 korrik, i shoqëruar nga avokati i tij mbrojtës. Ai u mor në pyetje si i dyshuar në hetime. Në atë seancë, Gjykata e Bosnje dhe Hercegovinës mori vendim për heqjen e paraburgimit, me kushtin që ai të paraqitej periodikisht tek organet kompetente të policisë. Kodi Penal i Bosnje dhe Hercegovinës parashikon dënim me burg deri në pesë vjet dhe ndalesë të mbajtjes së posteve publike për veprën penale të sulmit ndaj rendit kushtetues. Dodikut, ndërkohë, iu mor zyrtarisht mandati si president i Republikës Sërpska, pasi u dënua me një vit burg dhe me një ndalesë gjashtëvjeçare të mbajtjes së posteve politike publike. Radovan Vishković dha dorëheqje si kryeministër i Republikës Sërpska, ndërsa Nenad Stevandić vazhdon të shërbejë si kryetar i Kuvendit të entitetit.

Një në pesë fëmijë jetoi në zonë konflikti më 2024

Londër, 4 nëntor- Rreth 520 milionë fëmijë në gjithë botën kanë jetuar në zona konflikti më 2024, 47 milionë më shumë sesa në vitin paraprak, ose shifra më e lartë e regjistruar prej vitit 2005, sipas një raporti të organizatës ndërkombëtare për mbrojtje të fëmijëve, Save the Children. Organizata ka thënë se kjo nënkupton që një në pesë fëmijë në gjithë botën ka jetuar në një konflikt aktiv më 2024. Sipas raportit, janë identifikuar 41.763 “shkelje të mëdha kundër

fëmijëve” vetëm vitin e kaluar, çka përbën 30 për qind rritje prej vitit 2023, njëherësh shifër rekorde. Më shumë se gjysma e incidenteve kanë ndodhur në katër rajone: në territoret e pushtuara palestineze, në Republikën Demokratike të Kongos, Nigeri dhe Somali. Në përgjithësi janë regjistruar 61 konflikte nëpër shtete të ndryshme, edhe kjo shifra më e lartë prej vitit 1946. Florian Westphal, shef ekzekutiv

i degës së Save the Children në Gjermani, ka bërë thirrje për veprime politike urgjente. Në kohën e rritjes së përf forcimeve ushtarake në botë, mbrojtja e fëmijëve duhet të jetë në qendër të politikave të sigurisë, ka thënë ai, duke shtuar se është skandaloze që qeveritë po shpenzojnë më shumë në armë, sesa në mbrojtjen e fëmijëve në zonë konflikti. Gjetjet në raport janë rezultat i të dhënave të mbledhur nga Instituti për Kërkime të Paqes,



me bazë në Oslo, si dhe raportet e Kombeve të Bashkuara. Zonat e konfliktit përcaktohen

nëse në një zonë prej 50 kilometrash ka pasur të paktën një “incident konflikti” atë vit.

KRYEQYTETI NË ZGJEDHJE: PRISHTINASIT PRESIN FUNDIN E ‘KAOSIT URBAN’

Më 9 nëntor, Prishtina do të shkojë në balotazh ndërmjet Përparim Ramës (LDK) dhe Hajrulla Çekut (Vetëvendosje), pas një gare të ngushtë në rundin e parë, ku të dy morën mbi 33% të votave. Të dy kandidatët premtojnë zgjidhje për problemet e përditshme të prishtinasve, si trafiku i ngarkuar dhe mbeturinat, por disa qytetarë janë skeptikë pas premtimeve të parealizuara më herët. Analistët vlerësojnë se programet e tyre janë të ngjashme në përmbajtje, por dallojnë në qasje - Rama mbështetet më shumë në sektorin privat, ndërsa Çeku në atë publik

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Vëmendja e gjithë Kosovës do të jetë kryesisht te Prishtina më 9 nëntor. Kryeqyteti do të shkojë në balotazh për të zgjedhur kryetarin e ri, ndërsa qytetarët presin që kandidatët - Përparim Rama nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Hajrulla Çeku nga Lëvizja Vetëvendosje - t'u japin fund problemeve që prej vitesh e ngarkojnë jetën e përditshme: trafik i ngarkuar, mungesë parkingu, menaxhim i dobët i mbeturinave dhe hapësira publike që po pakësohen.

Të dy kandidatët premtojnë zgjidhje dhe krijimin e kushteve më të mira, por sfida për ta është e madhe: si do t'i bindin votuesit që premtimet e tyre nuk do të mbeten thjesht fjalë? “Radio Evropa e Lirë” provoi të bisedonte me të dy, por pa sukses.

Në anketën e zhvilluar me qytetarët, ata thonë se kanë ndjekur me kujdes premtimet dhe zotimet e kandidatëve. “Vota ime ka për të shkuar për kandidatin që do ta zgjidhë kaosin në trafik, do të kujdeset për hapësirat e gjelbra dhe parkingjet”, thotë Albert Krasniqi.

Ngjashëm mendon edhe Vjollca Misini, e cila trafikun e ngarkuar dhe rrugët e dëmtuara i sheh si një nga sfidat kryesore të kryeqytetit. “Do të votoj atë që ka dhënë premtime më bindëse, që të kemi pak më shumë rehati si qytetarë”, thekson ajo.

Arsim Sejdiu thotë se menaxhimi i mbeturinave dhe procesi i legalizimit të ndërtimeve janë çështje që ngecin prej vitesh. “Prej kandidatëve në balotazh, njëri ka premtuar që do të zgjidhë kaosin me mbeturinat dhe legalizimin e ndërtimeve. Do t'i jap votën atij që besoj se do t'i zgjidhë këto çështje”, thotë ai. Por, jo të gjithë qytetarët janë të bindur nga premtimet. Burimi Perani thotë se ato janë të mira, por se përvojat e mëparshme e bëjnë skeptik. “Kanë premtime të mira, por çdo herë ka pasur të tilla. Premtime boshe, në shumicën e rasteve. Mbase anoj... Ndoshta më pëlqen programi i partisë në tërësi dhe kjo do të më shtyjë ta votoj kandidatin që e mendoj”, thotë ai.

“Rama menaxher, Çeku reformues”

Politologu Albinot Maloku thotë se të dy kandidatët i kanë identifikuar të njëjtat probleme,



por ndryshojnë në stil dhe në konceptin e qeverisjes që propozojnë. “Rama përpiket të duket më pragmatist dhe më menaxherial. Kurse Çeku provon të duket më reformues. Rama flet për një periudhë dinamike katërvjeçare, kurse Çeku për një pasqyrim 10-vjeçar deri te ndryshimi”, thotë Maloku për Radion Evropa e Lirë.

Si garanci për realizimin e projekteve, ai shton se Rama ofron përvojën, ndërsa Çeku mbështetet te premtimi për

qeverisje bashkë me qytetarët. Megjithatë, Maloku vlerëson se disa premtime të të dy kandidatëve shkojnë përtej kompetencave komunale dhe varen nga mbështetja e nivelit qendror. “Rama ka disa premtime ambicioze që tejkalojnë kompetencën komunale, si ‘fshati olimpiq’ apo projekti i tramvajit. Çeku ka premtime më sistematike e të menaxhueshme ligjërish, por që kërkojnë vazhdimësi politike të mbështetjes nga ana e nivelit qendror”, shpjegon Maloku.

Çfarë zgjidhjesh premtojnë Rama e Çeku?

Çështjet si trafiku i rënduar, mungesa e parkingjeve dhe menaxhimi i dobët i mbeturinave kanë dominuar debatin që nga fillimi i fushatës për rundin e parë të zgjedhjeve lokale më 12 tetor. Kandidati i LDK-së, Përparim Rama, i cili synon mandatin e dytë, ka premtuar se do ta lehtësojë qarkullimin në kryeqytet përmes lidhjeve të reja ndërmjet lagjeve, si ajo mes Kalabrisë dhe Dardanisë, dhe ndërtimit të rrugëve nëntokësore.

Por, një raport i Institutit GAP kujton se të njëjtat premtime ai i ka bërë edhe në vitin 2021 - për

parkingje të mëdha, autobusë elektrikë dhe një fabrikë riciklimi - dhe ato nuk janë realizuar. Nga ana tjetër, kandidati i Vetëvendosjes, Hajrulla Çeku, kërkon t'i japë fund këtij cikli me një “model gjerman” për menaxhimin e mbeturinave, që do të fuqizonte ndërmarrjen publike dhe do të hapte mundësi për përfshirjen e bizneseve private. Ai premton, gjithashtu, rritje të flotës së autobusëve urbanë dhe ndërtim të parkingjeve të mëdha në hyrje të qytetit, me synimin që transporti publik të bëhet zgjedhja e parë për prishtinasit.

Sipas tij, problemet që prekin drejtpërdrejt jetën e qytetarëve të Prishtinës, si trafiku, parkingjet e mbeturinat, mbeten “katrahura urbane” që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme, pavarësisht se kush fiton.

Me këtë analizë pajtohet edhe analisti Ylli Hoxha, i cili thotë se programet e dy kandidatëve janë pothuajse të njëjta, sepse problemet e mëdha të Prishtinës janë tashmë të definuara në koncept-dokumentet për zhvillimin e kryeqytetit. “Projektet si ‘Unaza e jashtme’ dhe ‘Unaza e brendshme’, që synojnë të shkarkojnë trafikun, janë ide të vjetra, të mbështetura nga të dyja partitë që sot përfaqësojnë kandidatët - LDK dhe Vetëvendosje”, thotë Hoxha. “Prandaj, edhe zgjidhjet që propozojnë Rama e Çeku, janë të përafërta”, shton ai.

Sipas tij, dallimi qëndron në qasjen e secilit kandidat: Çeku mbështetet kryesisht te sektori publik, ndërsa Rama nuk e përjashton as partneritetin me sektorin privat.

Ai thotë se e njëjta logjikë shihet edhe te çështjet si menaxhimi i mbeturinave apo ngrohja qendrore.

Diferenca është vetëm në dinamikën dhe mënyrën se si synojnë t'i realizojnë premtimet, sipas Hoxhës.

Sipas të dy analistëve, programet e Ramës dhe Çekut mbartin

edhe ngjyime ideologjike.

Programi i Çekut, thonë ata, ka frymë më të majtë - me theks te barazia e qytetarëve dhe sektori publik - ndërsa ai i Ramës ka nuanca më të djathta, me mbështetje për partneritetin publik-privat dhe përfshirjen e sektorit privat në zhvillimin e qytetit.

Kokë më kokë në balotazh

Dy kandidatët kryesorë për kryetar të Prishtinës, Rama dhe Çeku, dolën pothuajse barabar nga runda e parë të zgjedhjeve lokale të mbajtura më 12 tetor. Sipas rezultateve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rama mori 33.79% të votave, ndërsa Çeku 33.01%, duke e çuar garën në një balotazh të ngushtë.

Në total, 18 nga 38 komunat e Kosovës do të zhvillojnë rundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë, më 9 nëntor.

Fushata për balotazh nis zyrtarisht sot dhe do të zgjasë deri në ditën e zgjedhjeve, megjithëse kandidatët dhe partitë kanë qenë aktivë në terren edhe gjatë periudhës së ndërmjetme.

Në Prishtinë, ku çdo votë mund të bëjë diferencën, gara pritët të jetë e ashpër dhe vendimtare - jo vetëm për fatin e kryeqytetit, por edhe për balancat politike në nivel vendi, sipas analistëve.



KONJUFCA MANDATAR PËR QEVERINË E RE, PARTITË E TJERA INSISTOJNË NË ZGJEDHJE TË REJA

Këshilli i Përgjithshëm i Lëvizjes Vetëvendosje ka emëruar Glauk Konjufcën si mandatar për kryeministër. Kjo ndodhi një ditë para skadimit të afatit 10-ditor të presidentes Vjosa Osmani për të dhënë mandatin për formimin e qeverisë së re. Ndërkaq Albin Kurti do të jetë kandidat për zëvendëskryeministër dhe ministër të Punëve të Jashtme. Në rast se presidentja Osmani e mandaton Konjufcën, në bazë të Kushtetutës së Kosovës, ai do të ketë afat 15 ditë që të paraqesë para organit ligjvënës përbërjen e re të ekzekutivit, i cili duhet të marrë të paktën 61 vota në favor

prezantojmë një Qeveri ku kryeministër nuk është Kurti dhe ky është kompromisi i madh. Tash e ka radhën opozita për kompromisin e vet”, ka thënë Konjufca.

Ai argumentoi se partitë e tjera shqiptare u bënë bashkë që t’ia pamundësojnë Kurtit formimin e ekzekutivit të tretë. “Populli shumë shpejt pret të rikthehesh më fuqishëm se në vitin 2021”, iu drejtua Konjufca Kurtit, duke iu referuar zgjedhjeve kur LV-ja mori mbi 50 për qind të votave. Sipas Konjufcës, interesi aktual publik, sipas partisë së tij është ndarë në dy shtylla. “Së parti shmangia e dy zgjedhjeve të mundshme brenda tre muajsh. Dhe së dyti votimi i buxhetit 2026, pa të cilin rrezikohen dimensionet vitale të shtetit, pagat e sektorit publik, pensionet, shtesat e projektet esenciale të shtetit tonë”, ka thënë ai.

Çështje të tjera që janë me urgjencë për miratim tha se janë Plani i Rritjes i Bashkimit Evropian, buxheti për transmetuesin publik të Kosovës dhe buxhetet për tri komuna: Prishtina, Gjilani, Zubin Potoku. “Partitë e tjera e kanë në dorë nëse duan të bëjmë zgjedhje tani. Por, mua më duket se shpata e gjykimit është më e mprehtë se më parë”, ka thënë Konjufca.

Në rast se presidentja Osmani e mandaton Konjufcën, në bazë të Kushtetutës së Kosovës, ai do të ketë afat 15 ditë që të paraqesë para organit ligjvënës përbërjen e re të ekzekutivit, i cili duhet të marrë të paktën 61 vota në favor. Në rast të dështimit, vendi shkon në zgjedhje të reja të jashtëzakonshme në dhjetor 2025.

Kush është Glauk Konjufca?

Glauk Konjufca është një nga figurat kryesore të Lëvizjes Vetëvendosje, pjesë e saj që nga themelimi, rreth dy dekada më parë.

Në vitin 2010 u zgjodh për herë të parë deputet dhe më pas shërbeu si nënkryetar i Kuvendit të Kosovës (2011-2014).

Në legjislaturat pasuese, ai udhëhoqi Grupin Parlamentar të Vetëvendosjes dhe ishte anëtar i komisioneve për Zhvillim Ekonomik dhe për Punë të Jashtme.

Pas zgjedhjeve të vitit 2019, Konjufca u zgjodh kryetar i Kuvendit të Kosovës, ndërsa më vonë shërbeu edhe si ministër i Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Qeverinë Kurti, deri në qershor 2020.

Nga viti 2021 deri këtë vit shërbeu sërish si kryetar i Kuvendit. Ndërkaq, nga 22 marsi 2021 deri

më 4 prill 2021 ishte edhe ushtrues i detyrës së presidentit të Kosovës.

**PDK, LDK dhe AAK
kërkojnë zgjedhje të
parakohshme parla-
mentare, thonë se askush
nuk e ka shumicën**

Partia Demokratike e Kosovës vlerëson se vendi ndodhet përpara një momenti vendimtar politik dhe institucional, që kërkon vendime të qarta, të përgjegjshme dhe në përputhje me realitetin politik në Kuvendin e Republikës së Kosovës. “Në një situatë ku është e qartë se shumica shqiptare në Kuvend, së bashku me disa deputetë të komuniteteve joshumicë joserbe, kanë shprehur qëndrimin e prerë se nuk kanë votë për një mandatar tjetër nga Lëvizja Vetëvendosje, çdo tentativë për t’ia dhënë sërish mandatin kësaj partie do të përbënte humbje kohe, zvarritje të panevojshme dhe thellim të mungesës së besimit në institucione. Ashtu siç dështoi Albin Kurti për të siguruar shumicën, do të dështojë çdo përpjekje tjetër për ta zgatur artificialisht këtë proces nga Lëvizja Vetëvendosje. Realiteti politik është i qartë: askush nuk e ka shumicën për të formuar

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Lëvizja Vetëvendosje ka propozuar nënkryetarin e kësaj partie, Glauk Konjufca për mandatar për kryeministër të Kosovës, ndërkaq Albin Kurti do të jetë kandidat për ministër të Punëve të Jashtme. “Unë marr vendin e Glaukut, e ai timin, siç jemi dakorduar bashkë mbrëmë”, ka thënë kryetari i LV-së, Albin Kurti gjatë mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm të partisë.

Ai iu referua postit të zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Jashtëm dhe Diasporës, ku Konjufca ishte caktuar në ekzekutivin e propozuar nga Kurti më 26 tetor - por që nuk mori mbështetjen e

61 deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Kurti ka thënë po ashtu se në këtë mënyrë mund të shmangen dy palë zgjedhje dhe Kuvendi të miratojë buxhetin për vitin 2026. Sipas tij, nëse vendi shkon në zgjedhje në dhjetor pa buxhet, do të rrezikohej shteti. “Caktimi i mandatarit të dytë në këto rrethana është domosdoshmëri. Le ta votojë opozita një qeveri të udhëhequr nga Glauku, në mënyrë që të procedohet buxheti i shtetit nga një qeveri fuqiplotë”, ka pohuar Kurti.

Në fjalën në Këshillin e Përgjithshëm, Konjufca ka thënë se mosmandatimi i Kurtit për kryeministër është “kompromisi i madh” i LV-së. “Më shumë se kaq nuk ka mundësi sepse po e

KFOR-i THOTË SE SITUATA E SIGURISË NË KUFI ËSHTË E QETË, PAS RAPORTIMEVE PËR RRËMBIMIN E NJË SERBI

MITROVICË, 4 NËNTOR - Misioni i NATO-s në Kosovë (KFOR) i ka thënë të hënën Radios Evropa e Lirë se është dijeni rreth njoftimit të Policisë së Kosovës se një serb i Kosovës dyshohet të jetë plagosur dhe rrëmbyer nga xhandarmëria e Serbisë brenda territorit të Kosovës, mirëpo situata e sigurisë në vijën kufitare administrative është e qetë. “Policia e Kosovës ka nisur hetime dhe vazhdon të jetë në kontakt të ngushtë me disa entitete, përfshirë KFOR-in. Policia e Kosovës e ka koordinuar aktivitetin e vet në anën kosovare të vijës kufitare administrative me KFOR-in”, është thënë në përgjigjen e këtij misioni. Autoritetet e Kosovës e kanë akuzuar të hënën Serbinë për cenim të integritetit territorial të Kosovës, pasi Policia e Kosovës ka bërë të ditur se më 1 nëntor ka pranuar informacion se në zonën e Leposaviqit, një shtetas i Kosovës, i nacionalitetit serb, me inicialet M.V., dyshohet se është plagosur dhe është rrëmbyer nga xhandarmëria serbe. Në anën tjetër, autoritetet në Serbi nuk janë deklaruar rreth këtij rasti. Sipas njoftimit të Policisë, vendi i ngjarjes ku raportohet se ka

ndodhur rasti dyshohet se gjendet brenda territorit të Republikës së Kosovës, pra brenda hapësirës [siç quhet pika zero -0-], në afërsi të zonës së Leposaviqit, qytet në veri të vendit, i banuar me shumicë serbe. Sipas këtij institucioni, Policia e Kosovës ka bashkëpunuar me misionin e NATO-s në Kosovë [KFOR] si përgjegjës për zonën/brezin kufitar. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani ka thënë se bota demokratike duhet të reagojë e t'i ndalë këto sulme të Serbisë. Sipas saj, “kjo është edhe një dëshmi shtesë e qasjes së saj hegjemoniste, ku çdo qytetar që guxon të flasë të vërtetën rreth regjimit autokratik të Vuçiqit, sulmohet dhe torturohet në mënyrën më barbare të mundshme”. Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla ka thënë se ky veprim është pjesë e politikave të Serbisë për frikësim dhe përndjekje ndaj qytetarëve që nuk i binden regjimit të presidentit serb, Aleksandar Vuçiqit. “Kjo qasje agresive dhe provokuese e Serbisë është e papranueshme. Ajo



përbën shkelje të rëndë të kufijve tanë shtetërorë dhe të të drejtave të qytetarëve tanë”, ka thënë Sveçla përmes një postimi në Facebook, dhe i ka bërë thirrje faktorit ndërkombëtar të reagojë ndaj Serbisë dhe që këto veprime armiqësore të mos përsëriten.

Çfarë tha tjetër Policia?

Policia e Kosovës tha se viktimja, i identifikuar me inicialet M.V., sipas dëshmitarëve është dërguar me një autoambulancë në drejtim të qytetit të Nishit në Serbi. Policia tha se ka intervistuar dëshmitarët okularë dhe përmes tyre ka siguruar informacionet se

“persona të maskuar kishin hyrë në territorin e Kosovës, duke e plagosur dhe rrëmbyer viktimën, të cilët pastaj e kishin dërguar në territorin e Serbisë”. Lidhur me këtë rast, Radio Evropa e Lirë ka dërguar pyetje në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrisë e Mbrojtjes të Serbisë, por deri më tani nga këto institucione nuk janë përgjigjur. Përgjigje nuk kthyen as nga Qendra Klinike Universitare në Nish. Informacionet e para lidhur me plagosjen dhe rrëmbimin e dyshuar i pari i bëri publike avokati Ivan Niniq në Serbi. Ai shkroi në X se Millan

Vukashinoviq ishte plagosur rëndë gjatë të shtënave në fshatin Jellakcë, afër Leposaviqit dhe se mjekët në Qendrën Klinike Universitare në Nish po tentojnë që t’ia shpëtojnë jetën. Leposaviqi gjendet në brezin kufitar mes Kosovës dhe Serbisë. Misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, është reaguesi i tretë i sigurisë në vend, pas Policisë dhe misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit, EULEX. KFOR-i, veç tjerash, është përgjegjës për sigurinë në vijën kufitare mes Kosovës dhe Serbisë. Kjo nuk është hera e parë që autoritetet e Kosovës akuzojnë xhandarmërinë serbe se hyn në territorin e shtetit. Në mars të vitit 2012, dy policë të Kosovës ishin arrestuar në fshatin Dumnicë të Podujevës. Pas 48 orësh ata ishin liruar. Ndërkaq, më 2023 tre pjesëtarë të Policisë së Kosovës ishin arrestuar. Sipas autoriteteve në Beograd, ata u kapën më shumë se një kilometër thellë në territorin serb, ndërsa zyrtarët në Prishtinë thanë se ata u rrëmbyen në Kosovë, gjatë një patrullimi kufitar.

Presidentja Osmani njoftohet mbi avancimet dhe kapacitetet profesionale të FSK-së



PRISHTINË, 4 NËNTOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtnant Bashkim Jashari, priti në vizitë presidenten Vjosa Osmani-Sadriu. Gjatë vizitës u mbajt një brifing informues i njësisë së Operacioneve Speciale të FSK-së, ku u prezantuan qëllimi dhe objektivat e njësisë. Gjatë këtij prezantimi gjithashtu u diskutua mbi avancimet dhe

kapacitetet profesionale të kësaj njësie elite të FSK-së. Presidentja Osmani dhe gjeneral Jashari ndoqën nga afër demonstrimin e një skenari të improvizuar, gjatë të cilit pjesëtarët e Operacioneve Speciale shfaqën nivel të lartë profesionalizmi, përgatitjeje dhe koordinimi. Presidentja Osmani dhe komandanti i FSK-së u shprehën të kënaqur me të

arriturat e përgjithshme të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe në veçanti me progresin e njësisë të Operacioneve Speciale. Në përmbyllje të vizitës, presidentja Osmani drekoi së bashku me pjesëtarët të gjinisë femërore të FSK-së, duke vlerësuar lart kontributin e tyre në zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve të Forcës, si dhe në promovimin e barazisë gjinore në shërbim të vendit.

qeverinë nga kjo legjislaturë”, thuhet në reagimin e PDK-së. PDK-ja konsideron se injorimi i këtij realiteti vetëm sa do ta thellonte krizën, do ta zgjaste pasigurinë institucionale dhe do ta dëmtonte më tej stabilitetin e vendit. “Në emër të përgjegjësisë dhe të besimit qytetar, Partia Demokratike e Kosovës bën thirrje për t’i dhënë fund çdo skeme zvarritëse, çdo improvizimi politik dhe çdo përpjekjeje për ta mbajtur peng shtetin për interesa të ngushta partiake. Aktualisht, zgjidhja e vetme e drejtë dhe demokratike janë zgjedhjet e reja të parakohshme, që do t’i kthejnë sovranit, qytetarit të Republikës së Kosovës, të drejtën për të vendosur drejtimin e ardhshëm të vendit dhe për t’i dhënë legjitimitet institucioneve të reja.

Kriza e stërzgatur gjatë këtij viti, e shkaktuar nga Lëvizja Vetëvendosje, përveç dëmit politik, ka goditur ekonominë, ka cenuar mirëqenien e qytetarëve, ka dëmtuar raportet me partnerët tanë ndërkombëtarë, ndërsa rreziku që buxheti i shtetit të mos kalojë më kohë dhe që vitin e ardhshëm qytetarët të mbeten pa paga, e bën edhe më të domosdoshëm përshpejtimin e procesit drejt zgjedhjeve të reja”, thuhet në reagimin e PDK-së. PDK-ja mbetet e përkushtuar të kontribuojë në çdo proces që i shërben stabilitetit, funksionimit normal të institucioneve dhe forcimit të demokracisë parlamentare në vend. Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se kjo shfaqje teatrale, e mandatarëve pa numra, pa shumicë e pa

legjitimitet demokratik, duhet të marrë fund. “Republika nuk është material loje për llogaritje të vogla elektorale. Republika mbetet më e madhe se secili prej nesh. Trajtojeni si të tillë. Bëhuni të vërtetë! Shikojeni qytetarët në sy e tregojuni se nuk ka shumicë. Tregojuni qytetarëve se secila parti shqiptare, ka dhënë verdiktin politik, të deponuar tashmë në Presidencë. Ky verdikt është i qartë e është i thjeshtë. Sot, matematikisht, me vullnetin e deklaruar politik, nuk ka mundësi për shumicë”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”. Ai ka shtuar disa pyetje: “Pse gjithë ky zell për lojëra pa dinjitet minimal politik? A nuk ju duken mjaft 8 muaj vonesë në shtetin më të varfër në kontinent për t’i dhënë vonesa shtesë. A është

qëndrimi me çdo kusht në pushtet edhe pa legjitimitet vlerë e re politike e një gjenerate që duhet të sjellë shpresë?”. Lideri i LDK-së ka thënë se këto zvarritje janë veç thellime të krizave, për të cilat do të mbahet përgjegjësi politike. “Dua të besoj se presidentja e Republikës, do të respektojë vullnetin e shumicës shqiptare, para mbledhjeve propaganduese të partive me mandatarë plot por pa shumicë parlamentare. Ky vullnet i është deponuar presidentes javën që shkoj, haptazi dhe qartë. Dua të besoj, se presidentja do të deklarojë gjënë më të thjeshtë e më logjike sot: fatkeqësisht, në këtë Kuvend, nuk ka shumicë parlamentare dhe asnjë mbledhje e asnjë partie nuk ndryshon këtë fakt politik”, ka thënë Abdixhiku.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se afati kushtetues për votimin e qeverisë përfundon të mërkurën dhe presidentja e vendit nuk ka mandat ta mandatojë askënd për krijimin e qeverisë, pa dëshminë se kandidati i nominuar e ka shumicën e nevojshme. “Shumica e nevojshme dëshmohe vetëm me nënshkrime të deponuara të deputetëve. Në çdo situatë tjetër presidentja bën shkelje të rëndë kushtetuese. Kandidatura e dytë nga LV-ja për qeveri është veç përpjekje për të vazhduar kapjen e institucioneve të shtetit, në kundërshtim me krejt normat kushtetuese e politike. Kjo farsë duhet të marrë fund menjëherë dhe vendi të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

KU NGE CI KOSOVA SIPAS RAPORTIT TË PROGRESIT

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Komisioni Evropian e ka publikuar të martën Raportin e Progresit për Kosovën për periudhën 2024-2025 ku thuhet se shteti ka bërë përparim, qoftë edhe të kufizuar, në disa fusha, por vë në pah ndikimin e ngërçit politik në rrugën evropiane të Kosovës.

BE-ja i përpilon këto raporte për vendet që synojnë anëtarësimin në bllokun evropian. “Periudha e raportimit u ndikua nga politikat e brendshme përçarëse dhe një fushatë përplasjesh përpara zgjedhjeve të përgjithshme më 9 shkurt 2025, pasuar nga një bllokim politik pas zgjedhor për shkak të pamundësisë dhe mungesës së vullnetit politik të partive politike për të gjetur një mënyrë për krijimin e institucioneve. Qeveria ka qenë në status të Qeverisë në detyrë që nga 23 marsi i vitit 2025 dhe ka funksione të kufizuara ekzekutive për të realizuar operacione të përditshme”, thuhet në raport.

Bashkimi Evropian, sipas Raportit të Progresit, që nga maji i këtij viti ka ndërmarrë hapa “për heqjen graduale” të masave ndëshkuese që vendosi ndaj Kosovës më 2023 për shkak të situatës së tensionuar në veriun e vendit, të banuar me shumicë serbe.

Raporti përmend se Kosova nuk i ka ratifikuar marrëveshjet që do t'i mundësonin të përfitonte nga Plani i Rritjes i Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor “për shkak të ngërçit politik”.

Që nga zgjedhjet e 9 shkurtit, Kosova ende nuk ka arritur të formojë ekzekutivin e ri, duke pamundësuar ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në Kuvend.

Plani i Rritjes - paketë në vlerë prej 6 miliardëeurosh, synon përshtetimin e rrugës së shteteve të rajonit në BE. Kosovës i kanë rënë hise rreth 900 milionë euro - që do të thotë se për kokë banori është përfituesja më e madhe e këtyre mjeteve.

Ngërçi politik dhe agjenda e BE-së

Sa u përket zgjedhjeve të 9 shkurtit, në raport përmendet tha se ato u zhvilluan në mënyrë të lirë dhe demokratike, ndërkaq fushata zgjedhore ishte garuese, “shpesh me retorikë të ashpër, keqpërdorim të burimeve publike dhe presion socio-politik në zonat ku shumica e popullsisë janë serbë”.

Sa i përket qeverisjes, “sfidat në raportin mes komunave dhe institucioneve qendrore vazhdojnë”, u tha në dokument. “Më 5 dhjetor 2024, Qeveria

miratoi një numër ligjesh, me procedurë të përshtetuar, duke rritur shqetësimet për parimet demokratike. Opozita, kritike e kësaj praktike, i sfidoi një sërë ligjesh në Gjykatën Kushtetuese”, tha raporti.

Duke folur për procesin e integritetit evropian, raporti tha se ndërsa Kosova publikisht riafirmon përkushtimin ndaj agjendës të BE-së, politikat përçarëse të brendshme dhe mungesa e prioritizimit kanë penguar që ato të zbatohen në mënyrë efektive”.

Ndërkaq, sa i përket Kuvendit, në raport thuhet se përbërja e mandatit të kaluar u përshkrua “me mungesë të konsensusit politik, shkeljeve procedurale, bojkoteve, thirrjeve të shpeshta të seancave të jashtëzakonshme dhe procedurave të përshtetura ligjore”. “Pavarësisht përmirësimeve të izoluara, sikurse përdorimi i sistemit për votim elektronik dhe publikimi i votave individuale të deputetëve, performanca e Kuvendit pësoi rënie”, u tha në Raportin e Progresit.

Dokumenti përmend edhe dështimet e deputetëve për të konstituuar Kuvendin pas zgjedhjeve të 9 shkurtit, duke theksuar se këto dështime “kanë minuar seriozisht funksionimin e institucioneve kyç demokratike”. Kuvendi u konstitua në fund të gushtit, pas një sërë përpjekjesh të dështuara dhe disa aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Lufta kundër korrupsionit

Kosova ka bërë “përparim të kufizuar” sa i përket luftimit të korrupsionit, u tha në gjetjet kryesore të Raportit të Progresit. “Kosova ka bërë përparim të mëtejshëm në gjykimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë, duke rezultuar në një numër të lartë të vendimeve përfundimtare nga gjykatat dhe shqiptim të dënimeve, ndërkaq numri i përgjithshëm i hetimeve dhe dënimeve të korrupsionit të nivelit jo të lartë ka rënë”.

Komisioni Evropian [KE] tha se Kosova ende vazhdon të mos ketë një kornizë strategjike për luftën kundër korrupsionit. “Pavarësisht deklarimeve për angazhim politik për përmirësimin e masave kundër korrupsionit, nuk ka një qasje koherente për këtë çështje. Për të pasur një luftë të efektshme kundër korrupsionit në të gjitha nivelet, Kosova duhet t'i përdorë më mirë ligjet ekzistuese kundër korrupsionit, përfshirë të Ligjit për konfiskim. Mjetet parandaluese sikurse deklarimi i pasurisë dhe planet për integritet të institucioneve publike duhet të përdoren më



mirë për të identifikuar dhe për të luftuar rrënjët e korrupsionit. KE-ja rekomandon që Kosova të forcojë edhe më shumë kapacitetin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, sa i përket stafit dhe ekspertizës, të zbatojë legjislacionin ekzistues dhe të miratojë një strategji kombëtare dhe plan të veprimit për luftën kundër korrupsionit 2025-2025 në linjë me praktikatat më të mira dhe standardet e BE-së.

Po ashtu vendit i rekomandohet që të përmirësojë cilësinë e hetimeve në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, të rrisë kapacitetin e njësive të posaçme të hetimeve të Policisë në mënyrë që ajo të bashkëpunojë më mirë me Prokurorinë Speciale. Ndërkaq, duke folur për luftën kundër krimit të organizuar, Raporti gjeti se Kosova ka bërë përparim në këtë fushë.

Gjyqësori dhe liria e shprehjes

Kosova ka bërë përparim të kufizuar në funksionimin e sistemit gjyqësor, tha KE-ja, duke përmendur se ka pasur përmirësime sa i përket problemit të vonësive të rasteve gjyqësore dhe duke theksuar se janë ndërmarrë disa masa për digjitalizim.

Në dokument thuhet se vendi është konsultuar me Komisionin e Venecias për një paketë ligjesh për gjyqësorin, duke bërë hapa drejt përafrimit me standardet evropiane. Por, Raporti vë në pah se dy institucionet, Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial vazhdojnë të

funksionojnë pa përbërje të plotë. “Për shkak të bllokadës politike aktuale, vonesat në hartimin e reformave të drejtësisë kanë ndikuar negativisht në përpjekjet për forcimin e mekanizmave për përgjegjësi dhe efikasitet brenda gjyqësorit dhe prokurorisë. Ndikimi i papërshtatshëm nga jashtë dhe brenda është i pranishëm”. Sa u përket të drejtave themelore të njeriut, Kosova duhet të bëjë përpjekje më të mëdha për promovimin, mbrojtjen dhe zbatimin e tyre, tha Raporti i Progresit.

Në dokument përmenden se janë bërë përparime sa i përket procesit të verifikimit të diplomave nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut dhe komisionit për verifikim i është zgjatur mandati. “Zbatimi i legjislacionit që mbron të drejtat e personave që i përkasin grupeve joshumicë, përfshirë të drejtat gjuhësore, ka nevojë për forcim. Disa masa të reja të miratuara nga qeveria kanë dobësuar më tej qasjen në shërbimet bazë për këto grupe. Miratimi i Kodit Civil dhe ndryshimet në Ligjin për lirinë e fesë mbeten të papërfunduara”. Në pjesën që flet për lirinë e shprehjes, Raporti përmend se Gjykata Kushtetuese ka anuluar Ligjin për Komisionin e Pavarur të Medias, “duke u dhënë autoriteteve udhëzime të qarta për të siguruar hartimin e shpejtë të një ligji të ri”. “Ndërsa peizazhi i mediave është pluralist, ai has sfida lidhur me transparencën në pronësinë e mediave dhe qëndrueshmërinë financiare. Mjedisi në veri të

Kosovës mbetet kufizues, duke nxitur vetëcensurë te publiku, mediat dhe shoqëria civile”, thuhet në raport.

Kosova këtë vit, sipas indeksit të Reporterët pa Kufij, ka shënuar rënien më të madhe në lirinë e mediave në 15 vjetët e fundit, duke u renditur në vendin e 99-të në botë nga 180 shtete.

Ndërkaq, sa u përket reformave në administratën publike, Raporti i bën thirrje Kosovës që të adresojë plotësisht rekomandimet e BE-së sa i përket Ligjit për zyrtarët publikë dhe aktvendimit të Gjykatës Kushtetuese për Ligjin për pagat në sektorin publik. Ndër rekomandimet që i bëhen Kosovës në këtë drejtim janë që t'i rrisë kapacitetet e shërbimit civil përmes punësimeve në bazë të meritave, të bëjë vlerësimin e performacës dhe të vendosë masa për të arritur barazi gjinore, të ulë numrin e pozitave vakante dhe me ushtrues detyre dhe të finalizojë sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës dhe të sigurohet që të funksionojë sistemi i ri i pagave.

KE-ja rekomandon që të rritet numri i shërbimeve elektronike, që do të ulte barrën administrative.

Periudha raportuese e këtij dokumenti është nga 1 shtatori i vitit 2024 deri më 1 shtator 2025. Raporti përpilohet nga të dhëna të marra nga shumë burime, përfshirë nga Qeveria e Kosovës, shtetet anëtare të BE-së, raporte të Parlamentit Evropian dhe informacione nga organizata të ndryshme joqeveritare ndërkombëtare dhe vendore.

Punëtorët e RTK-së protestojnë të enjten për mungesën e pagave

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Sindikata e Punëtorëve të Radio Televizionit të Kosovës (SPERTK) ka paralajmëruar protestë të enjten, në ora 11:00, për shkak të mosshpërndarjes së pagave. Sipas njoftimit, kjo është hera e dytë brenda tre muajve që punonjësit e RTK-së mbesin pa

paga, situatë që po krijon pasiguri ekonomike për punëtorët dhe po rrezikon funksionimin normal të institucionit. “RTK aktualisht gjendet para shumë projekteve me rëndësi të madhe, që lidhen drejtpërdrejt me misionin publik të saj, por edhe me interesin e

përgjithshëm të vendit. Kriza financiare rrezikon realizimin e këtyre projekteve dhe dëmton rolin e RTK-së si medium publik i pavarur dhe gjithëpërfshirës”, thuhet në komunikatë. SPERTK u ka bërë thirrje të gjithë punonjësve të bashkohen në protestë “për të mbrojtur

dinjitetin dhe të drejtën e tyre themelore për pagë”, duke paralajmëruar se situata financiare e transmetuesit publik po përkeqësohet. Nuk dihet ende nëse menaxhmenti apo institucionet përgjegjëse do të marrin masa para mbajtjes së protestës.



KUSHTETUESJA NË SHQIPËRI RIKTHEN VELIAJN NË KRYE TË TIRANËS

TIRANË, 4 NËNTOR - Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka rrëzuar një dekret të presidentit Bajram Begaj dhe një vendim të Qeverisë shqiptare, duke rikthyer në krye të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliajn, dhe duke anuluar mbajtjen e zgjedhjeve në këtë komunë. Në dekretin e rrëzuar të Begajt, 9 nëntori ishte shpallur datë për mbajtjen e zgjedhjeve të pjesshme lokale në Bashkinë e Tiranës. Ndërkaq, Kushtetuesja rrëzoi vendimin e Qeverisë shqiptare për shkarkimin e Veliajt. Begaj kishte nënshkruar dekretin për zgjedhje në Tiranë, pas vendimit të Qeverisë shqiptare për shkarkimin e Veliajt, bazuar në argumentin se ai kishte munguar në ushtrimin e funksionit të kryetarit për tre muaj.

Shkarkimi i Veliajt ishte inciuar nga Këshilli Bashkiak. Veliaj në ankesën dërguar në Kushtetuese kishte argumentuar se nuk ka mundur të ushtrojë funksionin e kryetarit të Tiranës për shkak se është në paraburgim. Veliaj u arrestua më 10 shkurt nën dyshime për korrupsion. Ai akuzohet për korrupsion që përfshin të paktën 1.1 milion euro fonde publike, të cilat pretendohet se u janë dhënë bizneseve e të cilat në këmbim i jepnin familjes së tij fitime të paligjshme. Veliaj - në mandatin e tij të tretë si kryetar bashkie - sipas Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK) dyshohet se ka krijuar një skemë korruptive mes disa kompanive në pronësi të bashkëshortes së tij dhe gjashtë biznesmenëve të lidhur me të.



Ai i ka mohuar të gjitha akuzat. Pas arrestimit të tij, SPAK tha se hetimet gjetën se Veliaj dhe bashkëshortja e tij kanë “ideuar, krijuar dhe vënë në funksionim një mekanizëm që ka synuar dhe

ka bërë të mundur, në praktikë, marrjen e përfitimeve të parregullta, të cilat burojnë nga fondet publike që administrohen nga Bashkia Tiranë, përmes titullarit të saj, me qëllim

pasurimin personal të këtij të fundit dhe familjes së tij, përmes veprimeve të kamufluara dhe të kundërligjshme”. Sipas SPAK-ut, hetimet kanë treguar se bashkëshortja e Veliajt, vetë ose përmes personave të afërt me të, ka bërë blerje online në vlerën 86.721.175 lekë (873.878 euro), kryesisht veshje dhe bizhuteri. Këto shpenzime nuk rezultojnë të jenë deklaruar, siç e parashikon ligji. Gjykata kishte urdhëruar edhe sekustrimin e disa llogari bankare të bashkëshortes së tij, Ajola Xoxa dhe shoqërive të lidhura me të, që kapin vlerën e 869.149 eurove. Ndërsa, në zyrat e një prej shoqërive të administruara prej saj ishin gjetur në një kasafortë dhe janë sekuestruar 95.350 euro, 14,900 dollarë dhe 665.000 lekë (6.700 euro).

SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS DHE SINDIKATA E POLICISË SË LITUANISË ARRIJNË MARRËVESHJE BASHKËPUNIM

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit sindikal ndërkombëtar dhe me qëllim të thellimit të marrëdhënieve profesionale ndërmjet organizatave policore, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet Sindikatës së Policisë së Kosovës (SPK) dhe Sindikatës së Policisë së Lituani (LPPS) – një hap i rëndësishëm institucional që konsolidon partneritetin sindikal, solidaritetin dhe zhvillimin profesional të punonjësve të policisë në të dy vendet. Marrëveshjen e nënshkruan



kryetari i Sindikatës së Policisë së Kosovës, Avdi Hoti, dhe presidentja e LPPS-së, Roma Katiniene, duke vënë themelet e

një partneriteti të qëndrueshëm ndërkombëtar në fushën sindikale, sociale dhe profesionale.

Ky bashkëpunim synon: Forcimin e solidaritetit ndërkombëtar sindikal midis policive të dy vendeve; Shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në mbrojtjen e të drejtave të punonjësve të policisë; Zhvillimin e projekteve të përbashkëta në fusha si arsimi, kultura, sporti dhe mirëqenia sociale; Rritjen e ndërveprimit profesional dhe institucional, përmes takimeve, trajnimeve dhe vizitave studimore të ndërsjella. Marrëveshja shënon një pikë kthese në ndërkombëtarizimin e sindikatës sonë, duke e pozicionuar Sindikatën e Policisë

së Kosovës si një faktor të rëndësishëm në rrjetin evropian të bashkëpunimit sindikal policor. Delegacionet e të dy sindikatave zhvilluan gjithashtu takime zyrtare në Pejë, vizituan institucione dhe objekte kulturore, duke diskutuar projektet që do të thellojnë bashkëpunimin dhe do të avancojnë mirëqenien e oficerëve në Kosovë dhe Lituani. Kjo marrëveshje është dëshmi e qartë se solidariteti dhe bashkëpunimi ndërkombëtar janë forca e vërtetë e sindikatave moderne, të përkushtuara ndaj mbrojtjes së të drejtave, dinjitetit dhe zhvillimit të anëtarëve të tyre.

Borovci dhe Sutaj diskutojnë për menaxhimin e pasurive të sekuestruara

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Koordinatori për Krime Kibernetike në Prokurorinë Speciale, prokurori special Halim Borovci, ka pritur të martën në një takim pune ushtruesin e detyrës së Drejtorit të Agjencisë për Administrimin

e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, Alban Sutaj. Tema e diskutimit ishte trajtimi dhe menaxhimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, me theks të veçantë në administrimin e aseteve digjitale.

Gjithashtu, u vlerësua se është thelbësore adresimi i mungesave ligjore dhe teknike që lidhen me menaxhimin e aseteve digjitale, me qëllim të rritjes së efikasitetit institucional. Prokurori special Borovci dhe Sutaj theksuan nevojën për

avancimin e bashkëpunimit ndërinstitutional në fushën e menaxhimit të këtyre pasurive, sidomos atyre digjitale, duke shprehur gatishmërinë për bashkëpunim të mëtejshëm dhe për angazhim të përbashkët.



Murati reagon ndaj Ramës: Po gënjen për buxhetin e Prishtinës

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, ka reaguar ndaj kryetarit të Prishtinës, Përparim Rama, duke e akuzuar këtë të fundit për dezinformim publik lidhur me buxhetin e Komunës së Prishtinës.

Përmes një postimi në “Facebook”, Murati ka publikuar një dokument zyrtar të Zyrës së

Kryeministrit të datës 31 janar 2025, për t’i kundërpërgjigjur deklaratave të Ramës, i cili kishte thënë se Qeveria e Kosovës ka bllokuar buxhetin e kryeqytetit. “Përparim Rama po gënjen publikisht për buxhetin e komunës. Këtë çështje e kam sqaruar tash e disa herë. Qe shkresa me të cilën qeveria i ka përcjellë Kuvendit materialin e

buxhetit të komunës qysh në janar të këtij viti”, ka shkruar Murati.

Në dokumentin që ai ka publikuar, Sekretari i Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit, Arben Krasniqi, njofton Sekretarin e Kuvendit të Kosovës, Arben Loshi, se Qeveria i ka dërguar Kuvendit vendimin për miratimin e kërkesës së

Komunës së Prishtinës për buxhetin e vitit 2025, pas miratimit paraprak në Kuvendin Komunal.

Murati ka shtuar se, përkundër dërgimit të materialit që në janar, buxheti nuk është votuar ende për shkak të mosgatishmërisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për ta përkrahur në Kuvend. “Pse



LDK-ja nuk po dëshiron për ta votuar buxhetin e Prishtinës tash që Kuvendi është konstituuar?”, ka pyetur ai.

MINATORËT KËRKOJNË RITJE PAGASH DHE VLERËSIM PËR PUNËN E TYRE

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Trepçës, kanë bërë një apel të hapur për rritje pagash dhe vlerësim të sakrificës së tyre, duke theksuar se puna e tyre ka kontribuar dukshëm në rritjen e prodhimit gjatë vitit të fundit.

Në një deklaratë për medie, Kryesia e Sindikatës së Minatorëve, thotë se minatorët po e ndjejnë çdo ditë rritjen e çmimeve dhe vështirësitë në jetën ekonomike. “Të gjithë po ndjejmë çdo ditë rritjen e çmimeve, rritjen e inflacionit dhe vështirësitë në jetën ekonomike. Ne, minatorët, prej shumë vitesh kemi punuar me durim dhe solidaritet për ndërmarrjen tonë, duke shpresuar që gjendja të përmirësohet, dhe kemi duruar pa kërkuar rritje pagash, edhe pse sektorë të tjerë kanë pasur lëvizje dhe përmirësime. Tani që qeveria ka paralajmëruar rritje pagash për sektorët publikë dhe ka premtuar pagën e 13-të, është normale dhe e drejtë që edhe menaxhmenti i

ndërmarrjes sonë të bëjë hapa konkretë për rritje të pagave të minatorëve”, thuhet në reagimin e tyre.

Tutje, theksohet se “Gjatë vitit të fundit, puna jonë ka sjellë rritje të dukshme të prodhimit”. “Ky sukses nuk do të kishte ndodhur pa përkushtimin e minatorëve. Prandaj, kërkojmë që puna dhe sakrifica jonë të vlerësohen dhe të shpërblehen me rritje pagash, po ashtu siç po ndodh në sektorët e tjerë publikë dhe privatë. Çdo ditë rrezikojmë jetën dhe shëndetin duke punuar në kushte të vështira dhe pa mjete të mjaftueshme”, vazhdon reagimi.

Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Trepçës shton se “Pa një ligj të veçantë që na mbron, detyrohem të vazhdojmë punën edhe kur rreziku është i lartë”. “Është koha që menaxhmenti të marrë vendime konkrete për mirëqenien tonë: rritje pagash dhe respekt për punën dhe sakrificat që bëjmë çdo ditë”.



RIZVANOLLI THOTË SE B1 GARANTON ENERGJI TË QËNDRUESHME EDHE PËR 20 VJET



PRISHTINË, 4 NËNTOR - Ministria në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka deklaruar se kapaciteti i njësisë B1 të TC Kosova B është rritur me 35 megavatë, pasi sipas saj, Korporata Energetike e Kosovës (KEK) realizoi investimin më të madh në më shumë se 40 vjet.

Rizvanolli ka rikujtuar se “prishja e kësaj turbine në kulm të krizës energetike në dhjetor 2021 (edhe pse modernizimi ishte planifikuar qysh vite më parë) na kushtoi me 50 milionë importe shtesë vetëm për atë muaj”.

Ajo ka thënë se ky investim siguron që prishje të tilla të evitohen dhe minimizohen. “Njësia B1 do të na sigurojë prodhim të sigurt edhe për 20 vite. Për më tepër, për çdo MWh tani digjet 1.15 ton qymyr në krahasim me 1.5 ton sa ishte më herët. Kur ka vizion, seriozitet e angazhim, rezultatet afatgjata vijnë, edhe nëse nuk janë të dukshme menjëherë. Nganjëherë këto duan edhe sakrifica siç ishte ndalja e bllokut B1 për më shumë se 6 muaj sivjet, por që janë sakrificat që i bartim sot për të ardhmen tonë e për

brezin e ardhshëm”.

Gjatë muajit qershor, ishte raportimeve se KEK-u për herë të parë s’ka prodhuar fare energji elektrike. Por, Rizvanolli pas këtyre raportimeve kishte përmendur edhe të ashtuquajturën “mafi energetike” në rajon, duke i hedhur poshtë pretendimet për lidhjet e saj me institucione të caktuara në Kosovë.

Mungesa e prodhimit e sasisë së energjisë elektrike për konsumatorët në Kosovë është mbuluar përmes importit nga jashtë.

Eksportet e Turqisë arritën në 24 miliardë dollarë në tetor, duke shënuar nivel rekord

STAMBOLL, 4 NËNTOR - Eksportet e Turqisë arritën në 24 miliardë dollarë, duke shënuar rritje prej 2.3 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në tetor, duke arritur nivel rekord.

Në një konferencë për medie në Stamboll, ministri turk i Tregtisë, Omer Bolat, tha se vendi arriti eksportet më të larta të tetorit dhe vendosi rekord të ri me eksportet që arritën në 270.2 miliardë dollarë në 12 muajt e

fundit.

Gjatë 10 muajve të parë të vitit, eksportet e vendit arritën në 224.6 miliardë dollarë, duke u rritur me 3.9 për qind nga viti në vit.

Importet në tetor u rritën me 6.6

për qind në 31.4 miliardë dollarë, kështu që deficit i tregtisë së jashtme ishte 7.4 miliardë dollarë muajin e kaluar.

Në periudhën janar-tetor, deficit i tregtisë së jashtme ishte 74.4 miliardë dollarë.



‘THE NEW YORK TIMES’ MË 1934: SHQIPËRIA E VOGËL NË LOJËN E MADHE DIPLOMATIKE



Herman Bernstein (1876–1935) ishte ambasador i Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, nga shkurti i vitit 1930 deri në shtator të vitit 1933 - një periudhë e shënuar nga përpjekjet e Shqipërisë nën mbretin Zog për të ruajtur pavarësinë mes Italisë dhe Jugosllavisë. Bernstein lindi në Nojshtat-Shirvint - sot Kudirkos Naumiëstis, në Lituani - në një familje hebreje, dhe emigroi në Shtetet e Bashkuara në vitin 1893. Atje punoi si gazetar, shkrimtar dhe përkthyes (i letërsisë

ruse), duke kontribuar në The New York Evening Post, The Nation dhe The Independent. Ishte redaktor i The Jewish Tribune dhe Jewish Daily Bulletin dhe udhëtoi në Evropë si korrespondent i The New York Times ku dokumentoi gjendjen e hebrenjve në Evropën Lindore dhe mbuloi Revolucionin Rus për New York Herald. Bernstein u takua me Herbert Hooverin në Konferencën e Paqes në Paris më 1919 dhe e mbështeti atë në kandidaturën për president në vitin 1928. Në

këmbim, Hooveri e emëroi ambasador në Shqipëri. Bernstein vdiq në Sheffield të Massachusettsit. Arkivat e tij, përfshirë disa shkrime mbi Shqipërinë, ruhen në Institutin YIVO për Kërkime Hebraike në Nju-Jork. Herman Bernstein kishte marrëdhënie të mira me mbretin Zog. Në artikullin e mëposhtëm, të botuar në New York Times, ai hodhi dritë mbi pozitën e vështirë të Shqipërisë në përpjekjet për të balancuar marrëdhëniet mes Italisë, Jugosllavisë dhe Greqisë.

Nga: Herman BERNSTEIN[1]
Përgatiti: Robert ELSIE

Çështjet e saj në krizë, Shqipëria i ndjek me kujdes në lëvizjet e ndryshme të blloqeve që udhëhiqen nga Franca dhe Italia. Shqipëria konsiderohet si një nga zonat më serioze të rrezikut në Evropë. Një luftë e re mund të fillojë atje nëse interesat politike dhe ushtarake të kombeve të tjera, për Shqipërinë, vazhdojnë të bien ndesh me njëri-tjetrin. Për shkak të pozitës së saj gjeografike, ky vend i vogël mban çelësin e Adriatikut dhe ka qenë mollë sherri mes kombeve të ndryshme për shekuj me radhë. Nga pikëpamja strategjike, vija bregdetare e saj do të kishte vlerë të paçmuar për Italinë - në rast lufte. Italia prej disa vitesh ka hedhur shumë të mëdha në Shqipëri, për të ndihmuar në organizimin e ushtrisë, për të ndërtuar rrugë, ura dhe fortifikime. Në Ballkan besohet se

përpjekja e Italisë për të militarizuar Shqipërinë është pjesë e programit të ambicies imperialiste - që i atribuohet Mussolinit - për të depërtuar në Ballkan, për të rimarrë rrugën e famshme romake Via Egnatia që kalon nëpër Shqipëri dhe Jugosllavi drejt Selanikut dhe Stambollit. Çdo lëvizje e Italisë në Shqipëri vëzhgohet me dyshim dhe shqetësim nga Franca, nga Antanta e Vogël dhe veçanërisht nga Jugosllavia. Gjatë disa viteve të fundit, ndihma financiare dhe udhëzimi ushtarak i ofruar nga Italia ndaj Shqipërisë, kanë shërbyer për të shtuar ndjenjën e nervozizmit në Ballkan dhe kanë bërë që Jugosllavia të ndërmarre përgatitje të ethshme ushtarake për të luftuar depërtimin e frikshëm italian në Ballkan.

Një ushtar i fuqive

Shqipëria e vogël është bërë kështu një ushtar [figurë

shahu] në lojën e dy blloqeve në konflikt në diplomacinë evropiane - njëri i udhëhequr nga Italia dhe tjetri nga Franca. Ajo ka përfituar deri-diku nga ky konflikt interesash dhe ka arritur të forcojë unitetin kombëtar, fillimisht me ndihmën e Jugosllavisë dhe më pas me ndihmën e Italisë. Cilado qofshin motivet e fshehta të këtyre kombeve, Shqipëria ka ruajtur me zgjuarsiri dhe guxim pavarësinë e saj - edhe pse është detyruar të bëjë shumë sakrificë, lëshime dhe kompromise në këmbim të ndihmës materiale që ka marrë që nga përfundimi i luftës [së Parë Botërore]. Nëse rrugët dhe urat e ndërtuara me ndihmën e parave italiane ishin apo jo të destinuara për planet ushtarake të Italisë, ato tashmë i shërbejnë qëllimeve të dobishme ekonomike të Shqipërisë, duke vendosur komunikime normale mes pjesëve të ndryshme të këtij vendi të vogël malor.

E pushtuar gjatë Luftës Botërore

Gjatë luftës [së Parë Botërore], Shqipëria ishte skenë e shumë pushtimeve. Ushtritë greke, serbe, franceze, austro-hungareze dhe italiane luftuan njëra-tjetrën në Shqipëri, dhe kjo tokë e vogël u nda në disa zona të ndikimit të huaj, ndërsa populli iu nënshtrua privimeve dhe mjerimit të papërshkrueshëm. Ahmet Zogu, mbreti i tanishëm, u internua në Vjenë gjatë gjithë periudhës së luftës. Pavarësia e Shqipërisë - e shpallur në vitin 1912 - u ndërpre. Në Konferencën e Paqes në Paris, kërkesat e saj fillimisht u injoruan plotësisht. Delegacioni paqësor shqiptar, i kryesuar nga Mehmed Bej Konica, vëllai i ministrit aktual shqiptar [ambasador] në Shtetet e Bashkuara, vendosi shpresat te presidenti Wilson dhe iu drejtua delegacionit amerikan që

Shtetet e Bashkuara, si fuqi e paanshme, të merrnin mandatin për Shqipërinë. Jugosllavia, Greqia dhe Italia ishin të etshme për të siguruar “sferat e tyre të ndikimit”. Në vitin 1919 u arrit një marrëveshje midis [kryeministrave] Clemenceau, Lloyd George dhe Nitti, në mungesë të përfaqësuesit amerikan, që i jepte Italisë mandatin mbi Shqipërinë nën Lidhjen e Kombeve, dhe ndante një pjesë të Shqipërisë së Veriut për Jugosllavinë. Shqiptarët protestuan kundër kësaj zgjidhjeje të imponuar që do t'i privonte nga pavarësia dhe do të copëtonte vendin e tyre.

Protesta e Wilsonit

Presidenti Wilson kundërshtoi fuqimisht marrëveshjen me arsyetimin se ajo ishte arritur në mungesë të përfaqësuesit amerikan dhe se synonte “t'i ndante shqiptarët, përkundër

protestave të tyre të fuqishme, midis tri fuqive të ndryshme të huaja”.

Pavarësia e Shqipërisë u shpëtua kur Qeveria amerikane deklaroi se “çështjet shqiptare nuk duhet të përfshihen në diskutimet e përbashkëta të propozuara midis Italisë dhe Jugosllavisë, dhe presidenti duhej të ripo-honte se ai nuk mund të aprovo-jë, në asnjë mënyrë, ndonjë plan që ia caktonte Jugosllavisë rajonet veriore të Shqipërisë - si kompensime territoriale për ato që i ishin mohuar diku tjetër...”! Dhe, “mbetej që Italia dhe Jugosllavia të zgjidhnin mos-marrëveshjet e tyre, nëse munden, përmes negociatave të ndara, me kushtin që nuk duhej të arrinin marrëveshje në kurriz të Shqipërisë”.

Shqipëria u pranua si anëtare me të drejta të plota e Lidhjes së Kombeve në dhjetor të vitit 1920, pas një fjalimi dramatik në mbrojtje të pavarësisë shqiptare nga Lord Robert Cecil - përballë protestave të disa shteteve ballkanike.

Një vit më vonë, ambasadorët e Britanisë së Madhe, Francës, Italisë dhe Japonisë, “duke pranuar se shkelja e këtyre kufijve ose e pavarësisë së Shqipërisë mund të përbënte rrezik për sigurinë strategjike të Italisë”, përfunduan një marrëveshje sipas së cilës “nëse Shqipëria në ndonjë moment do ta kishte të pamundur të ruante integritetin e saj territorial, ajo do të ishte e lirë t’i drejtohej Këshillit të Lidhjes së Kombeve për ndihmë të huaj”; se “qeveritë e Perandorisë Britanike, Francës, Italisë dhe Japonisë do të vendosin që, në rastin e përmendur më sipër, do t’i udhëzonin përfaqësuesit e tyre në Këshillin e Lidhjes së Kombeve që të rekomandonin që rivendosja e kufijve territorialë të Shqipërisë t’i besohej Italisë”.

Megjithëse tashmë anëtare e Lidhjes së Kombeve, Shqipëria nuk u konsultua fare në lidhje me këtë marrëveshje. Ajo protestoi kundër saj, duke deklaruar se nuk do ta njihje vlefshmërinë e saj. Deri më sot, Italia e konsideron Marrëveshjen e Ambasadorëve si një instrument detyrues ndërkombëtar që njeh interesat e saj të veçanta në Shqipëri, por pakti shihet me dyshim dhe frikë nga fqinjët e afërt të Shqipërisë në Ballkan; marrëveshja ka shërbyer kështu si burim përplasjeje, që prej asaj kohe, dhe e ka bërë Shqipërinë zonë të ndjeshme siç është edhe sot.

Në vitin 1920, italianët ende mbanin të pushtuar Vlorën, në Shqipërinë e Jugut. Udhëheqësit shqiptarë, të vendosur për ta çliruar vendin nga sundimi i huaj, detyruan ushtrinë italiane të tërhiqej. Më pas nisën të organizonin shtetin dhe të vendosnin rendin në vend. Ahmet Zogu ishte një nga udhëheqësit më të shquar të rinj, dhe qeveria ku ai ishte ministër i Brendshëm - dhe më pas kryeministër - u identifikua me emrin e tij. Në vitin 1924, regjimi i Zogut u



përmbys nga një revolucion i udhëhequr nga peshkopi shqiptar, Fan Noli. Ahmet Zogu, së bashku me disa nga bashkëpunëtorët e tij, u largua me shpejtësi në Beograd - për strehim dhe ndihmë. Qeveria revolucionare e Fan Nolit zgjati nga qershori deri në dhjetor të vitit 1924, kur Zogu - i cili ishte dënuar me vdekje prej saj - u kthye fitimtar në Tiranë në krye të një ushtrie të vogël që kishte organizuar në Jugosllavi.

Brenda një muaji pas kthimit në Shqipëri, Zogu u zgjodh për shtatë vjet president i Republikës Shqiptare. Qeveria e tij filloi të riorganizonte dhe modernizonte vendin. Por, shpërthimet e pakënaqësisë ndodhnin herë pas here. Jugosllavët, duke qenë se e kishin ndihmuar Zogun për të rimarrë pushtetin, prisnin prej tij që të kishte një orientim të fuqishëm pro-jugosllav, ose më saktë - anti-italian. Duke kup-tuar rrezikun e madh që një politikë e tillë paraqiste për vendin e tij, presidenti Zog u përpoq të ndiqte një rrugë të mesme - të ishte pro-shqiptar.

Pakti i Tiranës

Papritmas, në vitin 1926, ndodhi një kryengritje e rëndë në Shqipërinë e Veriut. Ahmet Zogu ishte i bindur se ajo ishte nxitur nga Jugosllavia. Si Italia ashtu edhe Jugosllavia i kishin propozuar atij një pakt miqësie dhe sigurie. Kjo kryengritje e detyroi të merrte një vendim të shpejtë në favor të Italisë dhe, më 27 nëntor 1926, ai nënshkroi një pakt pesëvjeçar miqësie dhe sigurie midis Shqipërisë dhe Italisë.

Ky dokument, i njohur si Pakti i Tiranës, deklaronte se Italia dhe Shqipëria, “në funksion të forcimit të marrëdhënieve të ndërsjella të miqësisë dhe sigurisë ... njohin se çdo trazim i drejtuar kundër status quo-së politike, juridike dhe territoriale të Shqipërisë, është në kundërshtim me interesat e tyre reciproke”.

Nënshkrimi i Paktit të Tiranës i futi në alarm dhe ankth fqinjët e Shqipërisë. Një vit më vonë,

menjëherë pas nënshkrimit të Traktatit Franko-Jugosllav, u lidh një traktat aleance midis Italisë dhe Shqipërisë për një periudhë prej njëzet vjetësh. Shqipërisë iu dha një hua prej 50 milionë franga ar nga Italia, përmes një grupi financiar italian të njohur si SVEA. Banka Kombëtare e Shqipërisë u themelua nën mbikëqyrjen e këtij grupi. Nisi një program i madh i veprave publike dhe ato u financuan nga kjo hua. Organizatorët ekonomikë, inxhinierët dhe sipërmarrësit italianë erdhën në Shqipëri. Po ashtu, mbërritën organizatorët dhe instruktorët ushtarakë italianë. U ndërtuan rrugë, ura dhe ndërtesa publike.

Çdo lëvizje në Ballkan vëzhgohet si nën një mikroskop. Jugosllavët i panë me dyshim përpjekjet e italianëve në Shqipëri. Ata i konsideronin traktatet italo-shqiptare, huan dhe ardhjen e organizatorëve dhe instruktorëve italianë si pjesë të një skeme politike dhe ushtarake për të siguruar një bazë të fortë në Adriatik, me synimin për të depërtuar në Ballkan. Beogradi e konsideronte një program të tillë si sfidë të drejtpërdrejtë ndaj Jugosllavisë. Situata ishte e rrezikshme.

Më 1 shtator 1928, presidenti Zog u shpall Mbret i Shqiptarëve nga një Asamble Kushtetuese, dhe Republika u bë Mbretëri. Gjenerali italian, Alberto Pariani, ndihmoi në organizimin dhe trajnimin e Ushtrisë Shqiptare. Xhandarmëria u organizua dhe drejtohej nga gjenerali britanik, Sir Jocelyn Percy. Gjykatat e drejtësisë u riorganizuan. U hapën shkolla të reja. U vendos një ritëm më i shpejtë në këtë vend të vogël, ku në të kaluarën “gjërat mund të arriheshin vetëm nëse kishe mjaft duhan dhe durim”.

Kur përfundoi periudha pesëvjeçare e Paktit të Miqësisë dhe Sigurisë, mbreti Zog refuzoi ta rinovonte, pavarësisht presionit të raportuar nga Mussolini. Mbreti Zog deklaroi se traktati nuk ishte më i nevojshëm, pasi ai nuk kishte nevojë për ndonjë fuqi të jashtme që ta mbronte. Ai gjithashtu theksoi se traktati i

tij i aleancës me Italinë, i cili do të mbetej në fuqi për disa vite, mbulonte të gjitha pikat që kishin të bënin me bashkëpunimin miqësor mes dy vendeve.

Situata kritike financiare

Ndërkohë, gjendja ekonomike dhe financiare e Shqipërisë kishte arritur një fazë kritike. Italia ofroi të ndihmonte sërish Shqipërinë duke i dhënë dhjetë hua vjetore me nga 10 milionë franga ar secila. Fqinjët e Shqipërisë u alarmuan, duke besuar se propozimi i Italisë nuk ishte gjë tjetër veçse një subvencion i ri për qëllime ushtarake. Huat vjetore do të shpenzoheshin nën mbikëqyrjen e një komisioni të përzier shqiptaro-italian. Shqipëria pranoi dhe dy huat e para vjetore u dhanë, megjithëse jo të plota. Huaja e tretë vjetore, këtë vit u mbajt pezull me arsyetimin se Shqipëria nuk po përmbushte kushtet e marrëveshjes për “bashkëpunim miqësor”.

Kur Italia i sugjeroi mbretit Zog, rreth një vit më parë, se një bashkim doganor midis Italisë dhe Shqipërisë do të ishte i pranueshëm për Italinë dhe do të ishte shumë i dobishëm për Shqipërinë, mbreti Zog e hodhi poshtë këtë sugjerim, duke kup-tuar se një marrëveshje e tillë jo vetëm që do të irritonte fqinjët ballkanikë, por edhe mund të shkaktonte trazira në të gjithë Evropën.

Më pas, Italia u irritua nga një ndryshim i befasishëm në Kushtetutën Shqiptare që çoi në mbylljen e disa shkollave të huaja dhe fetare. Qeveria shqiptare shpjegoi se kjo masë ishte e nevojshme, për momentin, për të konsoliduar unitetin kombëtar përmes sistemit të shkollës publike dhe për të parandaluar propagandën e huaj kundër kombit. Italianët refuzuan të pranonin drejtorët e tillë administrativë në shkollat e tyre. Ata i mbyllën shkollat dhe i dërguan mësuesit e tyre sërish në Itali. Zgjuarsia e ligjit të ri shqiptar për sistemin shkollor u vu në pikëpyetje, duke pasur parasysh mungesën

aktuale të mësuesve të kualifikuar shqiptarë.

Asnjë ndihmë më nga Italia

Qeveria italiane, duke qenë plotësisht në dijeni të gjendjes së dëshpëruar financiare të Shqipërisë, adoptoi një politikë të pritjes së kujdesshme, duke refuzuar çdo ndihmë të mëtejshme financiare. Importet e Italisë nga Shqipëria vazhduan të bien. Italianët mohuan se dëshironin ndonjë koncesion të ri në Shqipëri, se donin kontroll mbi ushtrinë, xhandarmërinë apo degë të tjera të qeverisë. Ata thanë se gjithçka që kërkonin ishte miqësia, bashkëpunimi miqësor dhe ndikimi kulturor. Mbreti Zog refuzoi të rihapte shkollat, por bëri një gjest të vullnetit të mirë duke urdhëruar që gjuha italiane të bëhej e detyrueshme në shkollat e mesme shqiptare. Kjo nuk i kënaqi plotësisht italianët dhe ata vazhduan të vononin huan e premtuar vjetore. Më pas, mbreti Zog urdhëroi një ulje drastike në buxhetin e vitit 1934. Ai i uli shpenzimet për ushtrinë pothuajse përgjysmë. Ai gjithashtu ia dhuroi shtetit një të katërtën e rrogës së tij dhe të shpenzimeve të familjes mbretërore për këtë vit. E gjithë kjo ndihmoi në rritjen e popullaritetit të mbretit Zog në mesin e shqiptarëve, por Roma ishte ende e zemëruar.


Problemi aktual

Shqipëria, duke e ditur mirë se shpresa e saj e vetme për rimëkëmbje qëndron në zhvillimin paqësor, po përpiqet të dalë nga ndërlikimet politike që rrezikojnë marrëdhëniet miqësore me fqinjët ballkanikë. Italia, Jugosllavia dhe Greqia kanë deklaruar vazhdimisht se janë kundër shkeljes së pavarësisë së Shqipërisë.

Ndërkohë, vazhdon beteja diplomatike e zgjuarsisë midis kryeministrit Mussolini dhe mbretit Zog. Deri tani, mbreti Zog duket se ka dalë fitimtar, për shkak se forca e Shqipërisë qëndron në dobësinë e saj. Së fundmi, ajo ka lidhur një traktat të favorshëm tregtar me Greqinë, dhe tani po negocion një traktat të ri tregtar me Jugosllavinë. Këto janë shenja të qarta të një bashkëpunimi më të ngushtë mes Shqipërisë dhe fqinjëve të saj ballkanikë.

Nëse Shqipëria arrin të vendosë marrëdhënie miqësore me fqinjët e saj ballkanikë, pa nxitur armiqësinë e Mussolinit, ky vend i vogël buzë Adriatikut, i quajtur “Toka e harruar e Evropës”, do të jetë në gjendje të zhvillojë në mënyrë paqësore dhe të suksesshme potencialin e saj bujqësor dhe ekonomik. /Telegrafi/

[1] Botuar në: The New York Times, New York, 28 janar 1934.



Ronaldo: S'dua të jem modest, por jam më i mirë se Messi



RIAD, 4 NËNTOR - Ylli portugez, Cristiano Ronaldo është shfaqur përsëri në një intervistë me Piers Morgan. Intervista do të transmetohet këtë javë, ka njoftuar Morgani, i cili ka zhvilluar një intervistë 80-minutëshe me Ronaldon në shtëpinë e tij në Arabinë Saudite.

Megjithatë, disa pjesë të intervistës janë publikuar, përfshirë një bisedë rreth Lionel Messit. Morgani ka cituar Wayne Rooney te Ronaldo, i cili ka thënë se nuk e urrente Ronaldon, por se Messi ishte një lojtar më i mirë se ai. Ronaldo është përgjigjur, duke

thënë se është më i mirë se Messi. "Nuk kam problem me këtë deklaratë, por nuk pajtohem, unë jam më i mirë se Messi. Nuk do të përpiqem të jem modest", ka thënë Ronaldo. Ronaldo e ka fituar Topin e Artë pesë herë, duke qenë lojtari më i mirë në botë në vitet 2008, 2013,

2014, 2016 dhe 2017. Ai ka qenë nënkampion gjashtë herë (2007, 2009, 2011, 2012, 2015 dhe 2018). Ndërsa Messi e ka fituar Topin e Artë tetë herë (2009, 2010, 2011, 2012, 2015, 2019, 2021 dhe 2023), dhe ka qenë nënkampion pesë herë (2008, 2013, 2014, 2016, 2017), çdo herë pas Ronaldos.

KOMBËTARJA E VAJZAVE TË KOSOVËS MËSON KUNDËRSHTARET PËR KUALIFIKUESET E BOTËRORIT 2027

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Kombëtarja e Kosovës në futboll për femra ka mësuar kundërshtarët për fazën e parë kualifikuese të Kampionatit Botëror 2027. Skuadra "dardane" do të garojë në Ligën C, duke synuar kalimin në fazën tjetër të garës. Sipas shortit të hedhur nga UEFA, Kosova

është vendosur në Grupin C2, ku do të përballlet me përfaqësueset e Kroacisë, Bullgarisë dhe Gjibraltarit. Një grup i balancuar, ku Kosova do të ketë mundësi reale për të luftuar për kreun. Përzgjedhësi dhe vajzat e Kosovës do të kërkojnë të përmirësojnë paraqitjet e mëparshme dhe të ndërtojnë

një skuadër konkurruese për të ardhmen. Objektivi kryesor do të jetë që ekipi të tregojë rritje, stabilitet dhe përfaqësim dinjitoz në arenën ndërkombëtare. Kualifikimet për Botërorin 2027 pritet të nisin vitin e ardhshëm, dhe ndeshjet e para do të jenë një test serioz për potencialin e futbollit femëror kosovar.




XHAKA PAS GOLIT TË PARË PËR SUNDERLANDIN: TË GJITHË E DINË SE JAM I LUMTUR KËTU

SUNDERLAND, 4 NËNTOR - Kapiteni i Sunderlandit, Granit Xhaka, ka shprehur kënaqësinë e tij që shënoi golin e tij të parë për "Macet e Zeza" në barazimin me Evertonin në Ligën Premier. Të besuarit e David Moyes kishin marrë epërsinë në minutën e 15-të me anë të golit të Ilman Ndiaye përpara se ylli shqiptar të rivendoste barazimin për vendasit në "Stadiumin e Dritave". Ndërsa ka shprehur gëzimin e tij për suksesin e tij personal, Xhaka ka thënë se

ndihet pak i zhgënjyer që ekipi i tij nuk mundi të merrte pikët maksimale nga kjo përballje. "Është gjithmonë mirë të shënosh golin e parë për klubin e ri", ka thënë Xhaka. Më tutje, ai ka thënë se është i lumtur në Sunderland. "Të gjithë e dinë që jam shumë i lumtur këtu dhe po përpiqem të jap më të mirën time. Ditë pas dite, në çdo ndeshje. Është për të ardhur keq që nuk morëm tre pikët, por jam gjithmonë i lumtur ta ndihmoj ekipin", ka deklaruar Xhaka.



EMËRLLAHU NË SHËNJESTËR TË KLUBIT TJETËR RUMUN



PRISHTINË, 4 NËNTOR - Mesfushori i Kosovës, Lindon Emërllahu po monitorohet nga skuadra tjetër e Rumanisë, e cila është thënë se po synon transferimin e tij në afatin kalimtar të janarit. Bëhet fjalë për Steauan, ekip

që ka ofruar 4.5 milionë euro për dyshen e Clujit, Lindon Emërllahun dhe Louis Monteanun. Sipas mediumeve rumune, Steaua veçse po bëhet gati për këtë lëvizje të dyfishtë, që po vlerësohet si goditje e madhe sportive dhe

ekonomike. Emërllahu 22-vjeçar, në fillim të këtij viti u transferua te Cluji nga Ballkani i Suharekës dhe me ekipin aktual ka kontratë deri në verën e vitit 2028. Ai po vlerësohet lart për paraqitjet e tij në kampionatin rumun, ku

këtë sezon ka realizuar 4 gola dhe ka bërë 2 asistime në 12 ndeshje të luajtura. Emërllahu ka edhe 12 ndeshje dhe 1 gol të shënuar me Kombëtaren e Kosovës, ndërsa kartoni i tij vlerësohet rreth 1.5 milion euro.

Fiorentina shkarkon Piolin

ROME, 4 NËNTOR - Skuadra e Fiorentinës ka shkarkuar trajnerin italian, Stefano Pioli pas rezultateve të dobëta që kjo skuadër ka

pasur gjatë këtij sezoni. Sipas raportimeve nga "SkySport" Pioli është liruar nga detyra e trajnerit dhe pritet të komunikohet

zyrtarisht nga klubi. Skuadrën do ta drejtoi trajneri i grupmoshave U20 Daniele Galloppa deri në gjetjen e një

zëvendësuesi. Pas 10 ndeshjeve në Serie A, Fiorentina nuk ka asnjë fitore dhe gjendet në pozitën e fundit në tabelë.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Andi” SH.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810366080 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Andi” D.O.O. Mitrovica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810366080 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Andi” L.L.C. with owner with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 810366080 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Diellza Krasniqi shpall të pa vlefshme diploma e fakultetit të Edukimit program Fillore në Prizren.

- Fatlind Shigjeqi shpall te pavlefshme deftesat e kl I - IX shfmu “ Vellezerit Frasheri “ Planej.

- Sylejman Shigjeqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Vëllezërit Frasheri “ Planej.

- Albatros Manxhuka shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme “Gjon Nikoll Kazazi”.

- Shqiprim Morina shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme “12 Maji”.

- “Fire Protection Agency Rifiel Action” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.

- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.

- Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.

- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.

- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13. si dhe Diplomën e sh.m. Prof. “Gjon Nikolle Kazazi” Teknologji Informative Gjakove.

- NNSH “Meridian”, shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1903

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

